



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 30.05.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kerkesës për rishqyrtim të datës 27.05.2019 të parashtruar nga grupi i Operatoreve Ekonomik "EJONA" për aktivitetin **:"Riparimi dhe rregullimi i ashensoreve"** dhe me numër të prokurimit: 616 -19-1538-521 nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet pjesërisht kërkesa e Operatorit Ekonomik "EJONA" e datës 27.05.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit **:" Riparimi dhe rregullimi i ashensoreve"**, me Nr.616 19 1538 521 kundër Njoftimit për Vendimin e AK-së ,dërguar me datën 22.05.2019 dhe publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Pezullohet Vendimi për dhënje të kontratës i publikuar me datë: 22.05.2019;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *aktivitetin ta kthej në rivleresim*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "EJONA" me datë 27.05.2019 ka parashtruar ankesën, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **:" Riparimi dhe rregullimi i ashensoreve"**. Autoriteti Kontraktues, me datë 30.05.2019, ka shqyrtuar ankesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet ankimore të tenderuesit:

-Tenderuesi në bazë të njoftimit për Vendimin e AK-së ka shprehur mospajtimin e tij lidhur me tenderuesin e propozuar për dhënje të kontratës.Pretendimi i tij ka të bëjë me çmimet jonormalisht të ulta që i propozuari ka në disa pozicione të pershkrimit të çmimit.Pretendimi i tij është trajtuar si pjesërisht i bazuar për faktin se sipas rregullave për tenderet jonormalisht nuk janë plotësuar të gjitha kushtet që tenderi i tenderuesit të rekomanduar për dhënje të kontratës të trajtohet si tender me çmim jo normalisht të ulët,por sipas pikes 3.2 të Rregullave

komisioni ka pase mundesine te kerkoj sqarime per disa pozicione te cilat kane çmime disa here me te ulta se sa çmimet e tenderueseve tjere.

Bazuar ne kete konstatoj se zyrtaret e prokurimit nuk kane ngritje profesionale te mjaftueshme per te verifikuar çmimet dhe per kete ky aktivitet duhet te kthehet ne rivlersim ne menyre qe te formohet nje komision profesional qe do te trajtoj çmimet e dhena ne tenderin e te rekomanduarit per dhenje te kontrates.

Nga konstatimet paraprake u vendos si në Dispozitiv të Vendimit.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit